

VENDIM
Nr. 340, datë 22.4.2015

**PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI
I MUZEUT “MARUBI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkëfinancimin, në vlerën e përgjithshme 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, për realizimin e zbatimit të projektit “Rikonstruksioni i muzeut “Marubi””, si pjesë e projektit HERA – menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore në zonën e Adriatikut, bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet komponentit IPA të bashkëpunimit ndërkufitar, dhe nga Fondi Shqiptaro-Amerikan.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i shtohet vlera e bashkëfinancuar nga qeveria shqiptare, e shtrirë në vite, si më poshtë vijon:

a) Për vitin 2015, i shtohet fondi prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë lekësh, i ndarë sipas zërave:

i) Zëri “Kosto lokale”, kapitulli “03”, fondi prej 11 670 000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh;

ii) Zëri “TVSH dhe taksë doganore”, kapitulli “04”, fondi prej 2 330 000 (dy milionë e treqind e tridhjetë mijë) lekësh.

b) Për vitin 2016, i shtohet fondi prej 41 000 000 (dyzet e një milionë) lekësh, i ndarë sipas zërave:

i) Zëri “Kosto lokale”, kapitulli “03”, fondi prej 34 167 000 (tridhjetë e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekësh;

ii) Zëri “TVSH dhe taksë doganore”, kapitulli “04”, fondi prej 6 833 000 (gjashtë milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë) lekësh.

3. Efekti financiar sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit i vitit 2015.

4. Efektet financiare sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të parashikohen dhe të planifikohen në planin e buxhetit për vitin 2016.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama